



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr.29, datë 07/06/2022

PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES SË KOMISIONIT AD-HOC PËR  
EKUIVALENTIMIN E GRADËS SHKENCORE PËR EFEKT TË MËSIMDHËNIES  
TË PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr.145, datë 10.03.2021 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë", Statutin e UART (*Funksionet e Senatit Akademik të UART*) si dhe Rregullores për funksionimin e Senatit Akademik, pasi u njoh dhe diskutoi draft-rregulloren përcjellë nga komisioni ad-hoc për ekuivalentimin e gradës shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies të personelit akademik, në Universitetin e Arteve, me Nr. 2 Prot., datë 26.04.2022, dhe pasi mori në shqyrtim propozimet e bëra nga një grup i anëtarëve të Senatit Akademik për disa ndryshime në draft rregulloren e paraqitur nga komisioni ad-hoc sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi të depozituar në këtë vendim, pasi i miratoi ato një nga një, Senati Akademik i Universitetit të Arteve, me votim të hapur:

VENDOSI

1. Të miratojë "Rregulloren e komisionit ad-hoc për ekuivalentimin e gradës shkencore, vetëm për efekt mësimdhënies së personelit akademik në UART.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Dr. Gjergj PREVAZI


Prof. Asoc. Albes FUSHIA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Erlind Fusha (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

UNIVERSITETI I ARTEVE



**RREGULLORE  
E KOMISIONIT AD-HOC  
PËR EKUIVALENTIMIN E GRADËS SHKENCORE  
VETËM PËR EFEKT TË MËSIMDHËNIES  
TË PERSONELIT AKADEMIK  
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

*Miratuar me Vendim të Senatit Akademik të UART*  
Nr. 29 datë 07 / 06 / 2022

**RREGULLORE E KOMISIONIT AD-HOC PËR EKVIVALENTIMIN E GRADËS  
SHKENCORE VETËM PËR EFEKT TË MËSIMDHËNIES TË PERSONELIT  
AKADEMIK**

Kjo rregullore është bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”, në VKM nr. 145 datë 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e UART.

**KREU I**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Kjo rregullore përcakton rregullat për ngritjen dhe funksionimin e komisionit ad-hoc për ekuivalentimin e gradës shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies të personelit akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në Universitetin e Arteve, në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë, akteve të tjera nënligjore si dhe Statutin e Universitetit të Arteve.
2. Çdo përcaktim i legjislacionit për arsimin e lartë, përfshirë aktet nënligjore apo Statutin e Universitetit të Arteve ka fuqi ligjore mbi çdo dispozitë të kësaj rregulloreje dhe zbatohet drejtpërsëdrejti në rast kundërshtie.

**KREU II**

**NGRITJA E KOMISIONIT AD-HOC PËR EKVIVALENTIMIN E GRADËS  
SHKENCORE VETËM PËR EFEKT TË MËSIMDHËNIES TË PERSONELIT  
AKADEMIK**

**Neni 2**

1. Ky komision, është organ kolegjal i krijuar në nivel institucional dhe ushtron veprimtarinë e tij në Universitetin e Arteve. Komisioni, ushtron veprimtarinë dhe merr vendime sipas kompetencave të parashikuara, në legjislacionin në fuqi, në Statutin e UART dhe në Rregulloren e këtij komisioni.
2. Komisioni ngrihet me vendim të posaçëm të Senatit Akademik të UART. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të komisionit përcaktohet nga Rregullorja e Universitetit të Arteve, e cila përmban rregulla të ndryshme për formimin, përbërjen dhe funksionimin e komisioneve.
3. Komisioni ad-hoc për ekuivalentimin e gradës shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies të personelit akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në Universitetin e Arteve, është struktura përgjegjëse për ekuivalentimin e gradës shkencore në Universitetin e Arteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin e UART dhe në këtë Rregullore.

**Neni 3**



**Procedurat e ngritjes së Komisionit ad-hoc për ekuivalentimin e gradës shkencore  
vetëm për efekt të mësimdhënies të personelit akademik me kohë të plotë dhe atij të  
ftuar në Universitetin e Arteve**

1. Komisioni ngrihet me vendim të posaçëm të Senatit Akademik të UART. Komisioni, përbëhet nga 5 anëtarë. Ata vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Nga lista e kandidatëve të vetëkandiduar sipas fakulteteve. Senati Akademik, me votim të fshehtë, zgjedh anëtarët e Komisionit. Secili fakultet duhet të përfaqësohet minimalisht me një anëtar në këtë komision.
3. Anëtarët e Komisionit, duhet që të plotësojnë këto kriteret:
  - a. të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
  - b. të mbajnë titullin “Profesor” dhe të kenë së paku 10 (dhjetë) vite përvojë në mësimdhënie pas fitimit të këtij titulli;
4. Kryetari i Komisionit, zgjidhet në mbledhjen e parë të konstituimit të tij me shumicë votash.

**Neni 4  
Baza ligjore**

1. Gjatë veprimtarisë së tij për vlerësimin e kandidatëve, Komisioni zbaton kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Statutin e UART, në VKM nr. 145 datë 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë” si dhe në këtë Rregullore.
2. Komisioni vendos me shumicën e votave të 5 (pesë) anëtarëve dhe me votim të fshehtë.

**Neni 5**

**Vakanca në komisionin ad-hoc për ekuivalentimin e gradës shkencore vetëm për efekt  
të mësimdhënies të personelit akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në  
Universitetin e Arteve**

1. Në rastet kur një nga anëtarët e komisionit, për arsye të dorëheqjes, sëmundjes, përfundimit të marrëdhënieve të punës apo për çfarëdo lloj shkakut tjetër, nuk mund të ushtrojë detyrën e tij për kohën e mbetur të mandatit, Kryetari i komisionit deklaron vakancën në mënyrë shkresore tek Rektori/ Kryetari i Senatit Akademik.
2. Rektori/ Kryetari i Senatit Akademik merr masat për shpalljen e vakancës dhe zëvendësimin e anëtarit të komisionit brenda 1 (një) muaji, sipas nenit 3 të kësaj Rregulloreje.
3. Vakanca shpallet në Fakultetin të cilit i përket anëtari i komisionit të larguar.

**Neni 6**

**Ekuivalentimi i gradës shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies të personelit  
akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në Universitetin e Arteve**

1. Për ekuivalentimin e gradës shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies, mund të aplikojë personeli akademik me kohë të plotë në UART, ose personalitete të fushës së artit me përvojë akademike të cilët ftohen të japin kontributin e tyre në mësimdhënie si personeli



- ftuar akademik me përvojë krijuese artistike dhe mësimore, dhe që përmbushin kriteret dhe standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të kësaj rregulloreje.
2. Për efekt të mësimdhënies në funksion të procesit akademik, për ekuivalentimin e kualifikimit për personelin akademik krijues dhe interpretues grada shkencore nuk përbën detyrim.
  3. Personelit akademik krijues dhe interpretues, me arritje të shquara artistike, i bëhet ekuivalentimi i aktivitetit artistik e krijues me punën kërkimore-shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies, në shërbim të vlerësimit të performancës akademike vjetore.
  4. Ekuivalentimi bëhet me vendim të Senatit Akademik, sipas përcaktimit në statutin e UART, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit.
  5. Figurat e shquara me një veprimtari të spikatur artistike, brenda dhe jashtë vendit, vetëm për efekt mësimdhënieje, pa gëzuar të drejta të tjera, thirren në UART të japin kontributin e tyre, sipas përcaktimeve në statutin e UART.
  6. Personeli akademik të cilit i është ekuivalentuar grada shkencore, e gëzon këtë ekuivalentim vetëm për efekt mësimdhënie.
  7. Personeli akademik që i njihet ekuivalentimi i gradës shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies nuk gëzon të drejtën e zgjedhjes në organet drejtuese të UART.
  8. Ekuivalentimi i gradës shkencore nga ky komision, personelit akademik nuk i jep mundësi për fitimin e titujve akademik në vijimësi.
  9. Për kualifikimin e tij, personeli akademik duhet të ndjekë procedurat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
  10. Në rast vlerësimi negativ të kërkesës për ekuivalentimin e gradës shkencore vetëm për efekt mësimdhënie nga Komisioni, kandidatit i lind e drejta të ri përsërisë kërkesën sipas shpalljeve të vendeve të lira të punës të propozuara nga njësia bazë dhe të miratuara nga Senati Akademik.

### **KREU III**

#### **PROCEDURAT PËR EKUVALENTIMIN E GRADËS SHKENCORE VETËM PËR EFEKT TË MËSIMDHËNIES TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË DHE ATIJ TË FTUAR NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

##### **Neni 7**

1. Lëndët e modulit B “*Lëndë karakterizuese*”, në ciklin e dytë Master, për të cilat do të ekuivalentohet grada shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies për stafin akademik, duhet të përcaktohen në çdo fillim viti akademik, nga njësiti bazë dhe përcillen nga përgjegjësi i njësisë kryesore, për miratim përfundimtar në Senatin Akademik të UART.
2. Propozimet për vendet e lira të punës, për stafin akademik që kërkohet tu ekuivalentohet grada shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies, bëhen vetëm për lëndët e modulit B “*Lëndë karakterizuese*”, mbështetur në planet mësimore të miratuara nga Senati Akademik dhe vetëm për ciklin e dytë të studimeve Master i Arteve, Master Shkencor dhe Master Profesional.
3. Kandidati protokollon kërkesën dhe dosjen pranë sekretarisë të drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë brenda 5 (pesë) ditëve pune.
4. Drejtuesi i njësisë bazë, mbas marrjes së dokumentacionit me shkresë përcjellëse të protokolluar, nga drejtuesi i njësisë kryesore, organizon punën për shqyrtimin e dokumentacionit brenda grupit mësimor të cilit i përket kandidati, dhe paraqet vlerësimin



- e grupit mësimor pozitiv ose negativ të kandidatit, brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditë pune dhe më pas ja përcjell drejtuesit të njësisë kryesore.
5. Nëse grupi mësimor të cilit i përket kandidati, jep vlerësim negativ, drejtuesi i njësisë bazë i kthehen dosjen e aplikantit, drejtuesit të njësisë kryesore me argumentet dhe sugjerimet përkatëse të njësisë bazë së bashku me grupin mësimor të cilit i përket kandidati.
  6. Pas vlerësimit pozitiv nga njësia bazë, brenda 10 (dhjetë) ditëve, dosja e kandidatit i përcillet komisionit ad-hoc nga drejtuesi i njësisë kryesore.
  7. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve, komisioni ad-hoc vlerëson nëse dosja e dorëzuar nga kandidati është e plotë apo jo. Në rast se dosja konsiderohet e plotë, komisioni vijon punën për vlerësimin e dosjes. Në rast të evidentimit të mangësive në dosjen e kandidatit, atij i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë për të bërë plotësimet e nevojshme. Në rast se ato nuk plotësohen brenda këtij afati, kandidati humbet të drejtën e ekuivalentimit.
  8. Data e nisjes së procedurës së vlerësimit të kandidatit konsiderohet data e dorëzimit të dosjes tek komisioni ad-hoc.
  9. Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e nisjes së procedurës së vlerësimit, komisioni shqyrton dhe përgatit raportin e vlerësimit të kapaciteteve akademike-didaktike artistike e shkencore të kandidatit sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore, në përfundim të cilit jepet edhe rekomandimi për ekuivalentimin e gradës shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies dhe i përcillet Senatit Akademik për miratim.
  10. Në rast refuzimi të kërkesës për ekuivalentimin e gradës shkencore vetëm për efekt të mësimdhënies, kandidati i lind e drejta të ri përsërisë kërkesën sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore duke filluar procedurën nga fillimi.
  11. Senati Akademik i UART, miraton kandidaturat e përcjella nga komisioni ad-hoc, me votim të fshehtë.
  12. Rektori i UART, mbështetur në Vendimin e Senatit Akademik, lidh kontratat njëvjeçare të punës.

## **Neni 8**

### **Kriteret dhe standardet për ekuivalentimin e gradës shkencore**

1. Ekuivalentimi do të bëhet vetëm për kategorinë e personelit akademik as/lektor, i cili do të japë mësim në programin e studimit të ciklit të dytë master. Ekuivalentimi u bëhet anëtarëve të personelit akademik të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:

#### **a) Në veprimtarinë akademike:**

- i. të kenë fituar diplomën "Master në Arte" pranë institucioneve të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.
- ii. të japin mësim në kategorinë (moduli) B, e cila i përket Lëndëve karakterizuese.
- iii. të kenë, së paku mbi 5 vite përvojë në mësimdhënie pranë UART;
- iv. të gëzojnë aftësi shumë të mira në procesin e mësimdhënies, shoqëruar me relacionet përkatës nga përgjegjësi i departamentit për secilin vit akademik;
- v. të njohë me dëshminë përkatëse një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht).
- vi. prioritet ju jepet si pjesëmarrës në veprimtari:
  - drejtues i projekteve artistike kombëtare dhe ndërkombëtare,
  - drejtues i komiteteve organizuese të veprimtarive artistike kombëtare e ndërkombëtare,
  - anëtar i komisioneve të veprimtarive artistike kombëtare dhe ndërkombëtare.



**b) Në veprimtarinë krijuese artistike:**

- i. Të kenë realizuar së paku, tri aktivitete krijuese artistike të rëndësishme si individë dhe të jenë recitale/premierë, si kompozitorë, si instrumentistë, si këngëtarë, si dirigjentë, si regjisor, si aktor, si scenograf apo kostumograf, korereograf, apo piktor tre ekspozita kolektive dhe një personale, skulpturë, instalacion të vendosura në hapësira ose aktivitete publike brenda dhe jashtë vendit.
- ii. Prioritet ka kandidati që ka realizuar vepra artistike në veprimtari ndërkombëtare.
- iii. Në fushën e kinematografisë të kenë realizuar njërën nga këto kërkesa:
  - dy filma me metrazh të shkurtër;
  - dy dokumentarë;
  - një film artistik me metrazh të gjatë.
- iv. Prioritet kanë kandidatët që janë vlerësuar me çmime kombëtare ose ndërkombëtare të fituara në aktivitete të rëndësishme artistike.
- v. Veprat të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/axhendat përkatëse si dhe të jetë shoqëruar me kritikë profesionale.

**Neni 9**

**Përmbajtja e dosjes të kandidatit për ekuivalentimin e gradës shkencore**

1. Materiali i dorëzuar në departament dhe që do të kalojë në komisionin ekuivalentimit ad-hoc: do të këtë:
  - a) Diplomën e mbarimit të shkollës së lartë të noterizuar;
  - b) Vërtetimin e viteve që ka punuar si as/lektor;
  - c) Dëshminë e gjuhës së huaj;
  - d) Vërtetimin nga Përgjegjësi i Departamentit për lëndët që ai do të ngarkohet të zhvillojë (të kategorisë B) ose që ka zhvilluar në këto vite;
  - e) Leksionet e printuara ose në CD si dhe botime n.q.s. ka;
2. Veprimtaria krijuese artistike:
  - a) Fletë palosjet, katalogë, axhendat përkatëse, posterat, kritika profesionale nga shtypi apo linkun e aktiviteteve, etj.;
  - b) Çertifikatat në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare;
  - c) Çertifikatat, diploma, kupa të fitimit të çmimeve, etj.;

**Neni 10**

**Ndarja e pikëve sipas veprimtarive për ekuivalentimin e gradës shkencore**

1. Pikët maksimale për kandidat janë 100. Në veprimtarinë akademike janë 50 pikë dhe në veprimtarinë krijuese artistike 50 pikë, të ndara si më poshtë:
  - a) Në veprimtarinë akademike:
    - i. aftësia në procesin e mësimdhënies, shoqëruar me relacionet përkatës nga përgjegjësi i departamentit për secilin vit akademik 15 pikë;
    - ii. përgatitja e materialeve mësimore (skripte, leksione, udhëzues praktikash ose ushtrimesh) për, së paku, një lëndë apo modul 10 pikë;
    - iii. përgatitja e cikleve të leksioneve për studentët 5 pikë;
    - iv. botimi i leksioneve ose materialeve didaktike mësimore 5 pikë;
    - v. pjesëmarrës në veprimtari;





- drejtues i projekteve artistike kombëtare dhe ndërkombëtare 5 pikë;
- drejtues i komiteteve organizuese të veprimtarive artistike kombëtare e ndërkombëtare 5 pikë;
- anëtar i komisioneve të veprimtarive artistike kombëtare dhe ndërkombëtare 5 pikë.

**Totali 50 pikë.**

- b) Në veprimtarinë krijuese artistike:
- i. aktivitetet krijuese artistike 20 pikë;
  - ii. realizimi i veprave artistike në veprimtari ndërkombëtare 20 pikë;
  - iii. vlerësimet me çmime kombëtare ose ndërkombëtare të fituara në aktivitete të rëndësishme artistike 10 pikë.

**Totali 50 pikë.**

## **KREU IV MBLEDHJET E KOMISIONIT AD-HOC**

### **Neni 11**

#### **Vendimmarrja në komisionin ad-hoc**

Vendimet e komisionit ad-hoc merren me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni. Çdo vendim duhet të jetë i miratuar dhe i firmosur nga të 5 (pesë) anëtarët e komisionit. Vendimi nëse nuk është i firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit është i pavlefshëm.

### **Neni 12**

#### **Thirrja e mbledhjes së komisioni ad-hoc**

1. Komisioni ad-hoc mblidhet si rregull një herë në vit.
2. Mbledhjet e shtyra apo mbledhjet në të cilat vazhdojnë të shqyrtohen çështje për të cilat shqyrtimi ka nisur në mbledhjet e mëparshme të Komisionit ad-hoc, do të konsiderohen si mbledhje të reja dhe nuk i nënshtrohen rregullit të afatit tremujor. Këto mbledhje zhvillohen jo më vonë se 4 ditë pune nga mbledhja pararendëse.
3. Mbledhja e komisionit ad-hoc, thirret nga Kryetari komisionit.
4. Kryetari i komisionit ad-hoc është përgjegjës për thirrjen e mbledhjes brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Rregullore.
5. Kryetari i komisionit ad-hoc, është përgjegjës për të mbajtur komunikim të vazhdueshëm me njësitë kryesore të UART, me qëllim identifikimin në kohë të çështjeve të mundshme për shqyrtim.

### **Neni 13**

#### **Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes së komisioni ad-hoc.**

1. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes së komisionit ad-hoc, bëhet me shkresë dhe i dërgohet anëtarëve të komisionit nga Kryetari ose me anë informimit elektronik, jo më vonë se 5 ditë pune nga data e zhvillimit të mbledhjes.



2. Njoftimi duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:
  - a) Datën dhe orën e zhvillimit të mbledhjes;
  - b) Vendin e zhvillimit të mbledhjes
  - c) Vendin (zyrën) ku mund të merret dokumentacioni që do të shqyrtohet në mbledhje.
3. Në rastet kur për arsye të ndryshme nuk është i mundur dorëzimi i shkresës, njoftimi sipas pikës 2 të këtij neni për thirrjen e mbledhjes, mund të bëhet edhe nëpërmjet postës elektronike. Secili anëtar i komisionit duhet të deklarojë që në mbledhjen e parë adresën e tij të postës elektronike. Njoftimi me postë elektronike, ka vlerë të njëjtë me njoftimin me shkrim.
4. Në raste të veçanta, thirrja e mbledhjes mund t'u njoftohet anëtarëve të komisionit edhe me telefon, me kusht që, brenda dy ditëve pasardhëse të punës, atyre t'u dorëzohet njoftimi me shkrim.

#### **Neni 14** **Vlefshmëria e mbledhjeve**

1. Mbledhja e komisionit ad-hoc do të konsiderohet e vlefshme nëse në të janë të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit.
2. Mbledhjet të cilat nuk janë njoftuar sipas procedurës së përcaktuar në nenin 10 të kësaj Rregulloreje, do të konsiderohen të pavlefshme.
3. Në rastet kur komisioni ad-hoc konstaton se një anëtar/e i/e komisionit mungon për të tretën herë radhazi në mbledhjet e komisionit me shkaqe të arsyeshme ose pa shkaqe të arsyeshme, është i detyruar të njoftojë menjëherë Kryetarin e Senatit Akademik të UART.
4. Mungesa, e trajtuar në pikën 3 të këtij neni, do të vlerësohet shkelje disiplinore dhe do të trajtohet sipas neneve të Statutit të UART për shkeljet disiplinore.
5. Për të gjitha çështjet e diskutuara dhe vendimet e marra, mbahet proces verbal i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit.

#### **Neni 15** **Hapja e mbledhjes**

1. Në datën, orën dhe vendin e caktuar në njoftim, Kryetari i komisionit ad-hoc hap mbledhjen dhe kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) verifikon praninë e anëtarëve të komisionit, verifikon rregullsinë e njoftimeve të bëra për anëtarët dhe nëse konstaton mungesa të anëtarëve të komisionit, cakton mbledhjen tjetër me të njëjtin rend dite, jo më vonë se 4 ditë pune;
  - b) jep udhëzime për njoftimin e anëtarëve që mungojnë;
  - c) jep udhëzime për shënimin në procesverbal të pjesëmarrjes së anëtarëve;
2. Rektori i UART cakton si sekretar të këtij komisioni një nga anëtarët e stafit administrativ të Rektoratit. Detyrat e të cilit janë:
  - a) të njoftojë anëtarët e Komisionit për datën, orën, vendin e zhvillimit të mbledhjes dhe rendin e ditës;
  - b) të përgatisë dokumentacionin e mbledhjes të dërguar nga drejtuesi i njësisë kryesore;
  - c) të mbajë procesverbalin e secilës mbledhje dhe të kujdeset për firmosjen e tij nga të gjithë anëtarët e komisionit;
  - d) ruan të gjithë dokumentacionin e këtij komisioni;



- e) mban kontakte me anëtarët e komisionit për problematika që mund të lind para, gjatë dhe pas përfundimit të mbledhjes së këtij komisioni;
- f) kujdeset që vendimet e komisionit të shoqëruara me shkresë përcjellëse nga Kryetari i tij të përcillen Senatit Akademik të UART ose njësisë kryesore në rastet e mos aprovimit;
- g) në përfundim të miratimit nga Senati Akademik të ekuivalentimit për secilin kandidat, me shkresë përcjellëse nga Kryetari i komisionit ad-hoc, protokollon në protokollin e Rektoratit të UART, të gjithë dosjen me dokumentacionin e aplikantit si dhe vendimet përkatëse.

### **Neni 16**

#### **Zhvillimi i mbledhjes, shqyrtimi i çështjeve dhe votimi.**

1. Shqyrtimi i çështjeve në komisionin ad-hoc, bëhet sipas radhës së përcaktuar në njoftimin e mbledhjes. Anëtarët e komisionit, mund të vendosin ndryshimin e radhës së çështjeve vetëm me shumicën e votave të anëtarëve të komisionit.
2. Kryetari i komisionit ad-hoc, paraqet çështjet të cilat do të shqyrtohen në mbledhjen e komisionit dhe fillon prezantimin e çështjeve sipas radhës së përcaktuar ose të miratuar. Në rastet kur mbledhja është thirrur nga një anëtar tjetër i komisionit, atëherë Kryetari e fton atë të prezantojë çështjen.
3. Pas prezantimit, Kryetari fton anëtarët të diskutojnë mbi çështjen. Diskutimet bëhen sipas radhës që përcakton Kryetari, dhe pasi Kryetari i jep fjalën çdo anëtar i komisionit.
4. Gjatë diskutimit, duhet të mënjanohen ndërhyrjet në diskutimin e anëtarëve të tjerë si dhe duhet të ruhet etika në komunikim. Anëtarët mund të diskutojnë më shumë se një herë, por gjithmonë duke mbajtur parasysh një kohë të arsyeshme për diskutimin.
5. Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari i komisionit ad-hoc, identifikon propozimet e paraqitura të cilat hidhen për votim.
6. Nëse gjatë votimit, ndonjë nga anëtarët e komisionit që ishte i pranishëm largohet, Kryetari i komisionit ad-hoc, anulon votimin.
7. Kryetari i komisionit hedh në votim propozimet sipas radhës së paraqitjes së tyre. Votimi në çdo rast bëhet i fshehtë. Fleta e votimit bëhet duke vendosur votën "pro" ose "kundër" për secilin emër të kandidatit.
8. Anëtarët e komisioni ad-hoc, nuk mund të abstenojnë.
9. Votimi i bërë një herë për një propozim, çështje apo vendim, nuk mund të kthehet dhe të përsëritet në mbledhje, me përjashtim të rasteve kur janë bërë gabime në formulimin e propozimit të paraqitur apo ka gabime të dukshme gjatë procedurës.

## **KREU VI DISPOZITA TE TJERA**

### **Neni 17**



Shkelja e dispozitave të kësaj Rregulloreje nga anëtarët e komisionit ad-hoc, apo persona të tjerë pjesë e personelit akademik apo administrativ të Universitetit të Arteve, përben shkak për dhënien e masave disiplinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e Universitetit të Arteve

### **Neni 18**

Kjo Rregullore mund të ndryshohet vetëm me Vendim të Senatit Akademik, me propozim të komisionit ad-hoc ose me propozim të Rektoratit.

### **Neni 19**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj në Senatin Akademik të Universitetit të Arteve.

